



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-kline.org

Komuna e Klinës

Kuvendi i Komunës

01Nr. 060-18746 2022

Klinë, 06. 05. 2022

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e Kuvendit të Komunës së Klinës, mbajtur me datë 06. 05. 2022, në sallën e Kuvendit, nisur nga ora 10:00.

Mbledhjen e pestë të Kuvendit të Komunës e hapi kryesuesi i Kuvendit, z. Fadil Gashi.

z. Fadil Gashi, Kryesues: Ju përshëndes të gjithëve. Mirë se keni ardhur. Përshëndetje në emrin tuaj dhe timin për kryetarin e Komunës, nënkryetaren, drejtorët e drejtorive, OSBE etj. Më lejoni që ta hap seancën e Kuvendit. Pjesëmarrës jemi 27 anëtarë të Kuvendit. Po shfrytëzoj rastin që të ja uroj ditëlindjen Valmir Bacajt se e pash një torte diku. Njoftimin bashkë me materialin e keni marrë me kohë. Jemi obliguar nga Ministria që ta zhvendosim për sot datën e mbledhjes së Kuvendit e jo qysh ka qenë e planifikuar para një jave sepse ne kemi gabuar në njoftim shkaku i një dite feste. Pra kjo është seanca e prillit. Tek Rendi i ditës unë kam një kërkesë nga ministria që ta fusim në rend dite një pikë shtesë, për rishqyrtimin e vendimit për ndarjen e parcelës në ZK Të Dresnikut për ndërtimin e objektit të zjarrfikësve.

Për rendin e ditës fjalën e morri:

z. Esat Raci: Përshëndetje për të gjithë. Të nderuar. Ne si grup kuvendar në seancën e kaluar në shenjë pakënaqësie shkaku i mos përgjigjes në kërkesën e grupit tonë, e kemi lëshuar seancën. I nderuar kryesues, unë tani dua të jua dorëzoj përgjigjen me shkrim që e kemi pranuar nga Kryetari i Komunës dhe ekzekutivi dhe ju në seancat e radhës na jepni përgjigjen se sa kanë qene reale dhe komfor kërkesës sonë përgjigjet që kemi marrë. Po jua dorëzoj këtë material sepse ju kryesues keni deklaruar se ne si anëtarë të kuvendit duhet të bëjmë kërkesa me shkrim që të marrim përgjigje me shkrim nga ekzekutivi, prandaj vlerësoni vetë se çfarë përgjigje kemi marrë.

z. Fadil Gashi, kryesues: Nëse e kam thënë këtë, qëllimi im ka qenë që të ju referoj adresën se ku të bëni pyetje dhe kërkesa për casje në dokumente zyrtare. As përgjigjet e ekzekutivit dhe as pyetjet e kërkesat e juaja individuale apo grupore nuk gjykohen e as vlerësohen nga unë.

Znj. Valmira Krasniqi: Përshëndetje të gjithëve. Unë kam një vërejtje tek rendi i ditës. Tek pika e 8 e Rendit të Ditës nuk është theksuar se nga kush është thirrur kjo interpelancë.

z. Fadil Gashi, kryesues: Faleminderit. Është kërkesa zyrtare. Kur të vijmë te ajo pikë mund ta theksoni ju vet. Unë e kam marrë një shkresë nga znj. Teuta Mulaj, koordinatore e qendrës Klinë. Ajo kërkon sqartim se ku ka me shkuar Kuvendi, qëllimi i vizitës etj. Duhet ta dini që unë ju jap llogari juve këtu e

askujt tjetër nga qendrat e partive tuaja. Në kalendarin e punës është vizita jashtë, e keni votuar këtë kalendar.

z. Zafer Gashi: Përshëndetje. Mos të ketë keqkuptime sepse mund të jetë ndonjë lëshim. Pika 8 nuk e thekson kush e ka thirrur e ndërkohë që një interpelancë tjetër është cekur. Unë jam shumë i kënaqur nëse këtë thirrje të interpelance e përkrahin të gjitha grupet Kuvendare nëse ky është qëllimi që nuk është theksuar kush e ka thirrur. Pra, le të shkruhet në procesverbal që këtë interpelancë e përkrahin të gjitha grupet kuvendare.

z. Fadil Gashi, kryesues: Rendin e ditës e cakton kryesuesi i Kuvendit në konsultim me kryetarin e Komunës. Pra, me vet faktin që është vënë në rend dite kjo pikë nuk diji si mund të jetë ndryshe respekti për kërkesat e juaja. Një kërkesë shumë legjitime dhe e drejt prandaj është respektuar. Nëse dëshironi e vejmë edhe theksin se kush e ka thirrur, nuk ka asnjë problem.

Kryesuesi e vendosi në votim Rendin e Ditës dhe me 27 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim U MIRATUA

Pika e 1. E Rendit të Ditës: Arsyetimi i Mungesave.

U konstatua që prezentë janë 27 anëtarët e Kuvendit

Pika 2 e Rendit të Ditës: Shqyrtimi dhe Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar.

z. Zafer Gashi: Është e vërtetë që ne së bashku me grupin e PDK-së jemi larguar nga salla në seancën e kaluar. Në procesverbal është shënuar fjala e grupit tonë, arsyet që ne i kemi dhënë shumë saktë por nuk është e drejt dhe është jo korrekte sqarimi hileqar i z. Kryetar i Komunës duke përmend të pa vërteta. Nuk mundet me thënë:....

z. Gashi vazhdon e lexon procesin dhe fjalën e kryetarit të Komunës në këtë rast. Ndërkaq kryesuesi z. Fadil Gashi ndërhyrë duke theksuar se procesverbali miratohet ose jo për saktësinë e shkruar të fjalës suaj në të e nuk është për tu debatuar se çfarë ka thënë njeri apo tjetri. Ai pyeti z. Zafer Gashi nëse kishte vërejtje për pasqyrim të fjalës së tij në proces. Zoti Zafer Gashi insiston që duhet ta shprehë mospajtimin me fjalën e kryetarit të thënë pasi që grupi i tij ka braktisur sallën.

Kryesuesi Gashi tha se z. Zafer Gashi, mund të kesh të drejt në këtë që po shprehë por kjo është për në pikën tjetër të rendit të ditës: Pyetje dhe Përgjigje e jo tek kjo pikë ku shqyrtohet procesverbali. Këtu mund të shprehni mospajtimin tuaj në lidhje me saktësinë e shkruar të fjalës suaj të thënë gojarisht.

Më pastaj fillon një dialog interaktiv me ndërhyrje që është e pamundur të mbahet shënim. Ne fund dakordohen që ta përfundojnë duke votuar procesverbalin.

Me 24 vota për, asnjë kundër dhe 3 abstenime (gr. Kuvendar i LVV) MIRATOHET

Pika 3 e Rendit të Ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimeve të KPF-së.

Kryesuesi z. Gashi theksoi se Rekomandimet i keni të gjithë. Shumica e rekomandimeve janë në rend të ditës dhe se vetëm tre kërkesa nuk janë në rend dite. Ai ju propozoi sipas praktikës që është ndjekur deri tani që këto rekomandime të votohen në Bllok ose të shqyrtohen dhe votohen një nga një.

Të gjithë shefat e grupeve Kuvendare u deklaruan që të votohen në bllok rekomandimet e KPF-së dhe me 17 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim U MIRATUA

Pika 4 e Rendit të Ditës: Shqyrtimi I raportit financiar për tre mujorin e parë të vitit 2022.

z. Ajet Sejdiu, Zyra e FEZH: Të nderuar të pranishëm. Drejtoria e FEZH duke u bazuar në ligjin për vetëqeverisje lokale, ligjin për menaxhimin e Financave, ligjin për buxhetin e Kosovës për vitin 2022, planin e punës së Ekzekutivit dhe statusin e Komunës ka pasur për obligimin ligjor punimin e raportit financiar për tremujorin që tani e keni edhe ju. Në këtë periudhë të vitit, sistemi I pagesave ka filluar me pak vonesë sepse buxheti nga ministria e financave dhe transferove është alokuar në fund të muajit shkurt të vitit 2022. Kjo ka ndikuar në vonesën e obligimeve financiare ndaj operatorëve ekonomik. Me gjithë këtë kemi arritur që të realizojmë planifikimet e bëra sipas buxhetit të aprovuar në Kuvendin e Komunës së Klinës. Risi tjetër në këtë periudhë ka qenë edhe ndryshimi në mënyrën e alokimit të mjeteve të planifikuara për buxhetin e vitit 2022. Në momentin e alokimit të mjeteve, ne kemi filluar menjëherë të bëjmë pagesat e mjeteve të mbetura e të grumbulluara si obligime. Sipas shënimeve që janë evidentuar edhe në raport, në këtë fillim vitit kemi rritje të të hyrave vetanake dhe zvogëlime të shpenzimeve.

z. Sejdiu në vazhdim të raportimit tha se ndikim në rritjen e shpenzimeve buxhetore në periudhat e ardhshme do të ketë gjithsesi inflacioni që është duke e goditur ekonominë e vendit, pra, rritja e vrullshme e çmimeve që do të ndikoj siç e thash në rritjen e shpenzimeve buxhetore. Por me sugjerimin e kryetarit për zvogëlimin e shpenzimeve , besoj që do të ja dalim që të realizojmë atë çfarë e kemi planifikuar për vitin 2022.

z. Sejdiu e përfundoi raportimin duke thënë në fund se raportin me përshkrime të zgjeruara e keni të gjithë dhe se për çdo informacion që ju intereson ai është në dispozicion për shpjegime.

Kryesuesi, z. Gashi duke e falënderuar zyrtarin e FEZH, Ajet Sejdiu, për raportimin para anëtarëve të Kuvendit, hapi debat rreth këtij raporti.

z. Ndrec Zefaj: Përshëndetje për të gjithë. E dëgjova me vëmendje përfaqësuesin e drejtorisë së FE Zh. Edhe unë e kam lexuar me vëmendje këtë raport të dërguar paraprakisht. Tek kategoria e shpenzimeve, kemi disa vërejtje ku prej tyre kam shkoqitur shpenzimet e udhëtimit Brenda vendit. Karburantet për vetura si dhe furnizim me ushqim dhe pije. Jemi të vetëdijshëm se krahasuar me periudhën e njëjtë me vitin e kaluar, këtë vit kemi inflacion por shohim se në këto tre kategori kemi shpenzime shumë të mëdha. Përafërsisht ka dyfishim të shpenzimeve. Kërkojmë nga ekzekutivi që në periudhat e ardhshme të kenë kujdes në shpenzimet.

z. Ajet Sejdiu, FEZH: Unë e thash edhe në raport se ne jemi zotuar që të bëjmë zvogëlime të shpenzimeve shkaku I inflacionit por nëse krahasojmë me vitin e kaluar , prap jemi nën shpenzimet e bëra për të njëjtën periudhë kohore.

z. Enver Gashi: Përshëndetje të gjithëve. Duke e lexuar këtë raport, dua të ndalem në shpenzimet. Më gëzon fakti kur shoh zvogëlime të shpenzimeve dhe kursim të buxhetit të taksapaguesve. Por ajo që më shqetëson në disa kategori ka rritje të shpenzimeve siç e tha edhe kolegu Zefaj. Fjalën e kam tek kategoritë që u përmenden. Kërkoj nga ekzekutivi që aty ku ka mundësi të reduktohen këto shpenzime.

z. Tunë Dedaj: Përshëndetje. Po thuhet që janë rritë shpenzimet. Unë kërkoj që mos t ë ndalet puna sepse janë rritë çmimet. Kërkoj që të reduktohen shpenzimet aty ku mund të reduktohen por assesi që të ndalet puna dhe shërbimet ndaj qytetarëve në emër të reduktimit të shpenzimeve.

z. Zafer Gashi: Përshëndetje. Dua shkurt ta marr fjalën sepse kolegët veçse theksuan disa kategori që janë rritur dukshëm shpenzimet. Në shëndetësi, sipas kësaj tablele në raport, krahasimi që është bërë me vitet 2020, 2021, shihet se në 2020 kanë qenë 50 mijë euro e pak më shumë shpenzime, në 2021 kanë qenë 40 mijë. Duke e bërë krahasimin me 2022 për periudhën e njëjtë, shtu këtu edhe faktin që pandemia ka rënë, vetëm në një kod, kodi 136-furnizime mjekësore, janë 17.108 euro. Ndërsa në periudhën e kaluar kanë qenë 3065 euro. A ka mundësi me na dhënë një shpjegim se për çka bëhet fjalë? Nëse është për furnizim të barnatores, apo shërbimet e rëntgenit etj. ju përshëndes.

z. Agron Bacaj, drejtor i Shëndetësisë: Përshëndetje për të gjithë. Është fakt që është rritë buxheti për furnizime mjekësore, kjo ka ndodhë për arsye se në tre mujorin e parë jemi furnizuar me gjithë materialin e nevojshëm për 6-të mujorin e këtij viti. Është furnizuar komplet Rëntgeni me filma, është furnizuar laborator me regjenca, është rritë numri i analizave. Aktualisht kryhen 17-të lloje të analizave në QKMF. Kemi filluar edhe me analizën e CRP-së që dihet se ka një kosto më të madhe. Gjithashtu kemi bërë furnizime të rregullta edhe me barna për barnatoren e QKMF-së. E tërë kjo ka ndikuar në rritjen për të cilën ju referuat. Besoj që është bërë mirë që janë furnizuar këta segment mjekësor.

z. Valmir Bacaj: Nuk e kisha mendjen me u përfshi fare në këtë temë pasi që raporti është pozitiv por meqenëse u përmenden shpenzimet dhe rritjet e këtyre shpenzimeve desha të dakordohem me drejtorin e financave dhe kolegët e tjerë se kjo është si shkak i rritjes së çmimeve në bursë. Por kemi edhe ulje të shpenzimeve që nuk po përmenden siç janë uljet e shpenzimeve të telefonisë vala, dreka zyrtare etj. Është mirë që kur të përmenden rritjet e shpenzimeve të përmenden edhe uljet e shpenzimeve.

z. Zenun Elezaj, kryetar i Komunës: Përshëndetje për të gjithë anëtarët e Kuvendit. Dua të ndërlidhem pak që edhe të i njoftoj qytetarët. Rritja e çmimit të energjisë elektrike ka arritur te rritja e faturave mujore. Zotimet bëhen çdo muaj dhe ne nuk kishim planifikuar për këtë rritje. Kemi bërë kërkesë që në rishikim të plotësohen këto mungesa duke kërkuar që mjetet e planifikuara për dhjetor të na barten për në muajin maj në mënyrë që të bëjmë pagesat ekstra që kanë dalë nga rritjet e çmimeve e që nuk ishin të planifikuara, kryesisht obligimet komunale. Jemi duke bërë maksimumin që ta përballojmë këtë vështirësi financiar që ka ardhur si pasojë globale e rritjes se berzes.

Pika 5 e Rendit të Ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për themelimin e komisionit për zgjedhjen e drejtorëve dhe zv. Drejtorëve në shkolla.

z. Qemajl Sejdiu, drejtor i DKA: Përshëndetje për të gjithë. Drejtoria e arsimit duke u bazuar në udhëzimin 151/2020, neni 6, paragrafi 3 dhe pika 3.1, e cila udhëzon për përbërjen e komisionit: një anëtar nga DKA, një ekspert i arsimit, ndërsa pika 3.2 thotë se anëtari i tretë i Komisionit është një anëtar nga MASHT. Anëtarët e propozuar të Komisionit për zgjedhjen e drejtorëve dhe zv. Drejtorëve, nga DKA i propozoj : 1. Astrit Muhaxheri nga DKA dhe 2. Lorenc Culaj, në cilësinë e ekspertit të arsimit. Do të doja që të votohet ky komision, ju faleminderit.

Për këtë çështje, kryesuesi i Kuvendit, z. Fadil Gashi hap debat.

z. Arben Limanaj: Përshëndetje. E kemi parë propozimin e bërë nga DKA dhe mendimi ynë si grup kuvendar është se njëri nga anëtarët e komisionit nuk i plotëson kriteret. Duke u thirrur në rregulloren për pranimin dhe punësimin e shërbyesve civil e cila thotë se çdo shërbyes civil i punësuar është për një vit në periudhë provuese, prandaj duke qenë kështu nuk mendojmë se mund të ngarkohet për

përzgjedhjen e drejtorëve dhe zv. Drejtorëve. Nëse vazhdohet me këta anëtarë jam i sigurt që ky konkurs do të anulohet. Prandaj ne si grup nuk e mbështesim këtë komision.

z. Zafer Gashi: bazuar në faktet që paraqiti Arben Limanaj, edhe ne si grup kuvendar nuk e përkrahim këtë Komision.

z. Zenun Elezaj, kryetar i Komunës: Mendoj që zyra ligjore është mirë me marr fjalën dhe me dhënë përgjigjen në shqetësimin që e tha Arben Limanaj. Telashe me komision të tillë kemi pasur edhe vitin e kaluar siç e dini. Ne e kemi një shërbyes civil në DKA që ka qenë edhe vitin e kaluar, z. Hajdin Morina, por që ai po priton me marr pjesë në këtë komision mbase shkaku edhe i moshës dhe obligimeve tjera. Nuk kemi tjetër zgjidhje përveç Astrit Muhaxherit. Unë besoj që s'kemi me pasur telashe ligjore pasi që z. Muhaxheri është i punësuar në DKA, megjithëkëtë është mirë që zyra ligjore ta jap mendimin e vet.

z. Driton Raci, zyra Ligjore: Përshëndetje. Sipas udhëzimit të Ministrisë së arsimit kërkohet që njëri anëtar i Komisionit duhet të jetë shërbyes civil i DKA. Unë nuk e kam dosjen e z. Muhaxheri që ta shikoj por mendoj që periudha provuese vlen për të punësuarit e rinj, ndërsa ata që kanë punuar edhe më parë në shërbimin civil nuk do të kenë nevojë që të i nënshtrohen edhe një herë periudhës provuese.

z. Arben Limanaj: Zyrtari ligjor e dha një arsytim por është dashtë ndoshta me na plotësuar shpjegimin sepse me udhëzimin administrativ 151/20 thuhet se anëtari i komisionin duhet të ketë përgatitje të barasvlershme me kandidatët. Anëtari në fjalë nuk e posedon këtë përgatitje. Nëse dikush konkurren me master, anëtari i propozuar nuk e ka masterin e kryer. Edhe ky është një fakt që dëshmon se nuk i plotëson kriteret.

z. Zenun Elezaj, kryetar i Komunës: Këtë e kemi konsumuar në mandatin e kaluar. Nuk kërkohej që anëtari të ketë përgatitje të barasvlershme me konkurrentët por të ketë përgatitje të barasvlershme me kërkesat e konkursit. Pra duhet ti ketë 240 kredi. Z. Hajdin Morina që ka qenë mandatin e kaluar i ka pasur 240 kredi dhe ka kaluar ligjshmërinë. Mendoj që në këtë aspekt nuk ka asnjë pengesë, sidoqoftë nëse zyra ligjore ka ndonjë mendim tjetër, e mirëpresim.

z. Valmir Bacaj: Ne kemi pasur telashe mandatin e kaluar për zgjedhjen e këtij komisioni. Do të doja një sqarim nga drejtoria se të dy kandidatët e propozuar a i kanë nga 240 kredi që kërkohen sipas udhëzimit administrative. Bashkëngjitja kësaj sqarimin që na e dha zyra ligjore, mendoj që është gjithçka në rregull. Është në interes edhe të qytetarëve edhe të gjithë neve që të procedohet sa më shpejt dhe të bëhet zgjedhja e drejtorëve dhe zv. Drejtorëve të shkollave e të mos bllokohet procesi sikurse në mandatin e kaluar. Ne si grup Kuvendar i AAK-së jemi PËR.

z. Qemajl Sejdiu, drejtor i DKA: Të dy propozimet i plotësojnë kriteret e kërkuara sipas udhëzimit që e ceka në fjalën time. Në udhëzim nuk specifikohet periudha provuese.

z. Zafer Gashi: Mendoj që z. Kryetar e din saktësisht sepse këtë bisedë e ka pasur edhe me këshilltarin e ministres së arsimit, z. Dervishaj. Ju lutem mos bëni presion që të shkelet ligji sepse dikush do të bëjë ankesë më pastaj.

z. Zenun Elezaj, kryetar i Komunës: Kjo ka ndodhë në rastin e parë kur në është kthyer negative ligjshmëria e komisionit por më pastaj kur kemi zgjedhë anëtarin nga DKA me 240 kredi është kthyer pozitive. Për mua është akoma e pa kuptimtë referimi që anëtari i Komisionit të jetë i punësuar në DKA-

administratë sepse për mua çdo l punësuar nëpunësit institucionet arsimore të Komunës është l punësuar në DKA. Besoj që jemi konform udhëzimit me propozimet e bëra.

z. Fadil Gashi, kryesues: Ne nuk guxojmë që të bijmë në situatë të njëjtë sikurse në mandatin e kaluar. Mendoj që është dashur që të ju lihet drejtorisë së arsimit të bëjë përzgjedhjen e drejtorëve dhe zv. Drejtorëve qysh e ka bërë edhe më përpara e aq më pak të sillet në Kuvend për votim komisioni që nuk propozohet nga kuvendi. Marrim vendim për një komision që ky kuvend nuk ka të drejt të propozoj. Ne si kuvend edhe nëse vendosim me l kthye këto propozime përsëri DKA ka me na l sjell propozimet e tjera. Edhe nëse kthehet negative ligjshmëria e këtij komisioni prap DKA ka me na l sjell propozimet e tjera. Nuk ka organ tjetër që bënë propozimet përveç se DKA sipas udhëzimit në fjalë.

z. Tunë Dedaj: Duke e marr para sysh që shumica e shkollave janë me zv. Drejtor unë ju bëjë thirrje të gjithëve , Pozitë e Opozitë që ta votojnë këtë komision sepse është në të mirë të qytetarëve tanë.

z. Zenun Elezaj, kryetar l Komunës: Mendoj që nuk kemi zgjidhje tjetër sepse në DKA vetëm Hajdin morina dhe Astrit Muhaxheri l plotësojnë kushtet. Hajdini sic e theksova më herët nuk ka pranuar.

z. Esat Raci: Nuk e patëm ndërmend të kyçemi fare në këtë pikë të rendit të ditës. Jemi kundër. Në mandatin e kaluar, ekzekutivi dy herë radhazi n a ka sjell propozime që nuk l plotësojnë kriteret. Me propozimin tim për z. Hajdin Morina , është sjellë dhe ka kaluar edhe ligjshmërinë. Unë nuk besoj që z. Hajdin Morina nuk ka pranuar këtë detyrë edhe pse kryetari thotë se nuk ka pranuar.

Ne vazhdim të debatit u përfshinë përsëri z. Arben Limanaj, l cili kërkoj që paraprakisht të konsultohet ekzekutivi me anëtarët e kuvendit për propozimin e bërë në seancën e ardhshme, Tunë Dedaj që kërkoj të vendoset në votim duke l bërë thirrje opozitës të votohet për, Valmir Bacaj l cili tha se është dashtë me mësuar nga praktikat e mandatit të kaluar dhe se opozita duhet të jetë konstruktive dhe të votohet Komisioni ose të jap një variant se si të bëhet zgjidhja e jo vetëm të thuhet jemi kundër. Zafer Gashi, l cili tha se duhet konsensus mes ekzekutivit dhe grupeve kuvendare. Bisedime dhe dakordime. Esat Raci që u pajtua se mos zgjedhja e drejtorëve është e dëmshme dhe kërkoj që drejtor e zv. Drejtor të jenë apolitik. Kryetari l Komunës, Zenun Elezaj që l propozoj opozitës që ata ta propozojnë emrin ASTRIT Muhaxheri sepse nuk ka tjetër zgjidhje. Kryesuesi Gashi që theksoi se propozime kuvendi me udhëzim nuk bënë por që mund të merret pauzë dhe të dakordohemi bashkë. Z. Limanaj kërkoj që paraprakisht të kontaktohet me përfaqësues të ministrisë dhe të konsultohen për propozimet e bëra. Kushtrim Halitaj l cili theksoi se nuk është problem vetëm tek Atriti por edhe tek Lorenc Culaj l cili sipas z. Haliti, nuk është ekspert l arsimit pasi që nuk ka master të kryer por ka rikualifikim. Kryetari l komunës përsëri shpjegoi se L. Culaj l ka 240 kredi dhe e ka kaluar në mandatin e kaluar ligjshmërinë dhe se përsëri e theksoi se nuk ka mundësi tjera. Z. Hajdin Morina e ka lutur por ai nuk ka qenë l gatshëm me marr pjesë në këtë proces prandaj mos të prolongohet më tej. Valmira Krasniqi e cila kërkoj që të mos zgjatet më shumë sepse po behët presion që të votohet për, më mirë të procedohet sipas propozimit të z. Arben Limanaj që të konsultohet ministria e arsimit paraprakisht. Etj. Kryesuesi duke parë që nuk ka konsensus mes pozitë e opozitë kërkoj që mos të vendoset me votim ky komision l propozuar. Në mënyrë që mos të lëndohen personat në fjalë. Ai bashkë me z. Bacaj propozuan një pauzë 5 minutash për konsultim të përbashkët por grupet opozitare e refuzuan duke theksuar se për këtë seancë s'ka konsensus. Z. Dedaj propozoj që të vihet në votim dhe të shihet se kush është për të mirë të qytetarëve dhe kush jo. Z. E. Raci u dakordua me propozimin e T. Dedajt dhe ashtu edhe ndodhi . Kryesuesi, z. Gashi e nxori në votim komisionin e propozuar:

Me 14 vota kundër, 10 vota për dhe 1 abstenim, NUK U MIRATUA.

Pika 6 e rendit të Ditës: Shqyrtimi I vendimit 01-nr. 06-10164 sipas shkresës së MAPL të datës 20 prill 2022.

Kryesuesi shpjegoi se është kthyer për rishikim një vendim I marrë nga kuvendi që ka të bëjë me planet e veprimt të shërbimit të ekosistemit të investimeve inteligjente në Komunën e Klinës.

z. Fadil Gashi, kryesues: Arsytet e kthimit në rishikim sipas shkresës së MAPL janë: Në nenin 140, 143 dhe 154 të ligjit për mbrojtjen e natyrës në të cilën është bazuar vendimi ynë, parashihet: nen 140 dokumentet bazë për mbrojtjen e natyrës, Komuna detyrohet të nxjerr programet për mbrojtjen e natyrës për territorin e vet. Ky plan ka të bëjë pikërisht për këtë çështje. Dhe 3. Programet duhet të harmonizohen me strategji.

Kryesuesi lexoi edhe nenet 143 dhe 154 që theksohen detajisht në shkresën e MAPL dhe thekson se të gjitha këto kritere ligjore janë të përfshira Brenda këtij plani porse na e kanë kthyer dhe ne duhet ta bëjmë. Jemi duke e rishikuar sipas kërkesës. Të mos penalizohemi pa të drejtë prandaj duhet ta rishikojmë.

z. Valmir Bacaj: Ne si grup kuvendar jemi për rishikimin e këtij vendimi dhe të harmonizohet sipas kërkesës së MAPL

z. Zafer Gashi: Në një debat të tillë kam marr pjesë edhe unë. Edhe ne I përkrahim harmonizimet që duhet të bëhen. Por le ta dimë që Komuna e Klinës ka nisur të bëjë degradim të ambientit dhe investimet inteligjente në ruajtjen e natyrës duhet të jenë primare ashtu sikurse janë theksuar në këtë program.

z. Zenun Elezaj, kryetar I Komunës: Ky është një projekt I marrë nga projekti I bashkëpunimit ndërkuftar Kosovë-Mali I zi , është një e arritur e Komunë së Klinës dhe është I financuar nga BE. Konsulentët që e kanë punuar këtë projekt janë pikërisht ata që e kanë punuar projektin e BE.

Kryesuesi e vuri në votim dhe me 27 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim MIRATOHET

Pika 7 e Rendit të Ditës: Shqyrtimi dhe miratimi I propozim vendimit për krijim e kodeve të reja për participim me qytetarë për realizmin e projekteve të serave dhe makinave mjelëse.

z. Ajet Sejdiu, FEZH: Ministria e financave sipas rregullave të reja, në ato momente kur ka bashkëfinancim me donator duhet të krijoj kode të reja financiare. Prandaj ne kemi dy vendime, njeri është për sera bujqësore e tjetri vendim është për makina mjelëse. Ky është obligim I kuvendit që na duhet ta dërgojmë në ministri.

Znj. Besiana Gashi: Përshëndetje të gjithëve. Kam një pyetje për drejtorin e bujqësisë. Në vitin 2021, me datë 8 shkurt është bërë thirrja publike për të aplikuar për projektin e ngritjes së serave e që kanë aplikuar afër 500 veta. Atyre u është dashur që të nxjerrin fletën poseduese të pronës e cila ka kushtuar 4 euro e që kur shumëzohet me numrin e aplikuarve del të jetë 2000 euro. Dua të di që çfarë ka ndodhur me këtë thirrje dhe ku kanë përfunduar këto mjete. Apo ishte thjesht një premtim elektorale.

z. Zenun Elezaj, kryetar I Komunës: Ju e dini se vitin e kaluar parashikimet buxhetore kanë qenë më të vogla. Kur e kemi shpallë tenderin për përcaktimin e fituesit për furnizim me sera, çmimi ka qenë shume

herë më l madh. Ka qenë edhe fundi l vitit dhe nuk ka pasur mundësi që të vazhdohet me këtë projekt. Prandaj është dashur që të fillohet me një proces të ri këtë vit.

z. Kushtrim Haliti: Pyetja që ngriti kolegja. Mjetet prej 2000 euro ku kanë mbetur. A mundet dikush të na l arsyetoj.

Kryesuesi theksoi se është pika e rendit të ditës për krijimin e kodeve të reja dhe se është pika ku mund të bëhen pyetje e përgjigje.

Me 27 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim U MIRATUA

Pika 8 e Rendit të ditës: Interpelanca me kryetarin e Komunës të kërkuar nga LVV për 100 ditshin e qeverisjes lokale.

z. Zenun Elezaj, kryetar l Komunës: 100 ditshi l qeverisjes në mandatin e ri sigurisht, bazuar edhe në programin qeverisës të ekzekutivit janë të ndara përgjegjësitë në shërbimet e përditshme ndaj qytetarëve duke l dalur për zot përgjegjësi tona që na ngarkon ligji dhe me sukses të plotë kemi arritur që të realizojmë përgjegjësitë që ka ekzekutivi dhe administrata e Klinës. Përmes programit qeverisës kemi adresuar problem të caktuara për vendim marrje në këtë kuvend siç janë plani l punës, planifikimi financiar, ai l prokurimit etj. Jemi gjithashtu në përgatitje të politikave zhvillimore- strategjinë zhvillimore të komunës së Klinës 2021-2027. Në fakt është e gatshme kjo strategji dhe besoj që në seancën e ardhshme do të vije në Kuvend për shqyrtim. Jemi në përgatitje të planit zhvillimor komunal si dokument bazik ku do të shikohet edhe plotësimi dhe ndryshimi edhe i hartave zonale. Në kuadër të realizimit të objektivave financiare është shumë inkurajuese shkalla e të hyrave që për tre muorin e këtij viti kap shifrën prej 612 mijë e 638 euro. Dëshiroj që të l falënderoj qytetarët për kryerjen e obligimeve të tyre ndaj Komunës. Tek projektet , sigurisht që edhe unë l kam shqetësimet e mija për këtë vit siç u raportua në raportin financiar- rritjet e çmimeve në berzë. Problemet më të mëdha janë me projektet dy vjeçare për të cilat janë të lidhura kontratat vitin e kaluar dhe vazhdojnë edhe këtë vit dhe përkundër presionit tonë të madh tek OE nuk po fillojnë punimet. Ne tani jemi në situatë ku përmes Asociacionit të Komunave kemi kërkuar nga Qeveria e republikës që ti rishqyrtoj këto situatë të krijuara dhe të rritën vlerat e kontratave duke u bazuar në çmimet në Berzë. Është fjala për kontratat e firmosura. Mund të ju themi se ata po lëvizin simbolikisht por jo me ndonjë gjë konkrete. Jemi para dy sfidave. Të ndërpreme kontratat dhe të konfiskojmë sigurimin e kontratës çdo kompanie por çfarë të bëjmë në raste kur kontrata shembull ka vlerë 200 mijë euro, ne duhet të ja shtojmë edhe 200 mijë të tjera për të realizuar projektin. Për momentin nuk e kemi asnjë mundësi të bëjmë një veprim të tillë sepse nuk kemi buxhet për shtesë të buxhetit. Realisht jemi në pritje të një vendimi të qeverisë sepse të gjitha komunat e kanë këtë situatë sikurse ne. Një vendim për shtimin e vlerave të kontratave. Informata kemi që mund të vijë deri të një vendim l tillë l qeverisë sepse ka ngecje gjithandej në realizimin e projekteve. Jo vetëm kontratat e lidhura në vitin e kaluar por edhe kontratat e reja kanë problem gjithashtu. Ne sipas planit të prokurimit kemi proceduar shumë projekte të reja por kemi problem sepse ofertat janë shumë më të mëdha se sa planifikimi. Shkaku l inflacionit. Kjo do të na detyron që të bëjmë reduktime projektesh, p.sh. kur është fjala për rrugët, shembull rruga 3 kilometra do të reduktohet në 1.5km etj. Janë vështirësi që na kanë vënë në një pozitë mjaft sfiduese. Edhe fati l projektit të furnizimit me ujë të pijshëm që është bashkëfinancim ka fatin e njëjtë me projektet e tjera. Përfundimisht jemi duke pritur reflektim nga qeveria, konkretisht nga Ministria e zhvillimit ekonomik me të cilën kemi memorandum bashkëfinancimi dhe të zhbllokohet vazhdimi l këtij projekti mjaft të rëndësishëm për qytetarët tanë.

z. Lirije Gashi: Përshëndetje të gjithëve. I nderuar kryetar kam një pyetje për juve. Në programin tuaj premtues ju keni thënë se për studentët e dalluar ju do të ndani 60 bursa. Në fakt janë 40 bursa. Pasi që unë isha në komision për bursa kam një sugjerim që në vitin tjetër, si kriter të jua jepni mundësinë studentëve të atyre familjeve që janë me asistencë sociale ose me kushte të rënda ekonomike si dhe të futen në kriter edhe drejtimet e tjera. Keni premtuar që të gjitha shkollat e Komunës do të l pajisni me laborator të Kimisë, biologjisë, fizikes. Kur do të filloj pajisja e tyre?

z. Zenun Elezaj, kryetar komune: Sa l përket premtimeve të mia për 60 bursa, këtë vit e kemi rritur në 40, vitet e ardhshme do ta rrisim akoma më shumë. Ka qenë premtim për 4 vite por veçse ka filluar implementimi. Sa l përket kriterëve të ndarjes është një rregullore e kuvendit por nëse vjen iniciativa për ndryshimin e saj mund at bëjmë bashkërisht.

z. Fadil Gashi, kryesuesi: Nëse duhet me e futë kategorinë që po e përmendni duhet ndryshuar rregullorja.

z. Zafer Gashi: Në ekspozenë tuaj të shkurt kryetar, kuptova shumë pak. Ajo që unë ju kam përgëzuar për këto 100 ditë ka qenë me bazë e ajo është takimet e tuaja kryetar me Organizata jo qeveritare. Po ashtu jeni takuar edhe me përfaqësues të CDI që më ka [pëlqyer shumë. Në postimet e tuaja me atë rast thoshit se të paktën në dy fshatra në qershor do të kemi ujë. Që ka mos realizime të premtimeve për këtë periudhë, po ka dhe janë të shumta. Ka projekte që ju thatë që janë ndaluar, p.sh, impianti në Sferkë, në Volljak, premtimi l stacioni l autobusëve që keni përmendur kupola peronesh etj. Ngulfatja e hapësirave publike në qytet, keni dhënë leje për fabrikën e çimentos, kontratat e paligjshme për punësime, kontrata për disa punë që janë dy vjeçare e s'po kryhen, shqetësimet e qytetarëve për ambientin në Klinë. Sidomos shqetësuese është gjendja në shkollën fillore "Fehmi Agani" është hap konkursi por aty janë mësimdhënës të pa kualifikuar. Kur jemi te punësimet, ato nuk po ndalen se rehabilituar militantët e AAK-së. Shembull atje ku është drejtor kolegu im në shëndetësi, aty herë e çelni një konkurs herë e mbyllni për disa teknik që ju ke premtuar që do të punësohen nëse votojnë AAK. Njeri nga ata kandidatë ka dalë me video ku thotë se ka pasur preferencë nga Zenun Elezaj që njeri nga doktorët të pranohet. (ndërhyjnë drejtori l Shëndetësisë duke thënë që është anuluar ai konkurs). Shkeljet e rregullave janë shumë evidente ndaj anëtarëve të LVV e në veçanti ndaj meje personalisht. Është bërë edhe publike rasti l reklamës së biznesit tim. Tjetër, kryetari l qet në lojë edhe disa njerëz të ndershëm e që ne nganjëherë gabojmë dhe jua përmendim emrat por s'kemi qare pa jua përmend. Kemi rastin e pranimit të drejtorit të QKMF-së. Është bërë falsifikim l dokumentit zyrtar, Komuna e falsifikon dokumentin zyrtar. Komuna e poston ne ueb zyrtar konkursin ku kërkohet të jetë specialist l mjekësisë familjare si dhe specialist l fushave të tjera të mjekësisë, ndërsa në statusin e QKMF-së është shumë e definuar mirë se për zgjedhjen e drejtorit kriter është vetëm Specialist l Mjekësisë familjare. Për me marr ligjshmërinë nga pushteti lokal, e qet në lajthitje sepse jua dërgon konkursin sipas statusit të QKMF-së, pa shtesën – si dhe specialist l fushave të tjera të mjekësisë. Unë me 19 maj të atij viti l kam kërkuar që zotëria në fjalë që është edhe hero l mjekësisë në Klinë, të zgjidhet me kontratë sikur të tjerët e mos t ë shkelet ligji. Këto janë vetëm disa nga të shumtat që ne kemi fakte. Këto shqetësime mos t i merr kryetari si pozicione revanshiste. Skam asgjë personale me kryetarin, ne si subjekt politik po kërkojmë që z. Zenun Elezaj të jetë kryetari l 6 muajve të parë të mandatit të kaluar. E diji që ju mund të qeverisni drejt dhe mirë por jeni futë thellë në shkelje të ligjit.

z. Zenun Elezaj, kryetar l Komunës: Pakënaqësitë e Zafit po vazhdojnë të jenë të shumta. Unë po ndalem vetëm tek ato që janë konstruktive. Për vizitat që l përmende dhe projektin në fjalë, ai është

projekt që po përfundon këto ditë në Budisalc, është projekt për ujin e pijshëm. Është financim i CDI dhe do të përfshij të gjitha fshatrat- Budisalc, Jagodë, Krushevë etj. Projekti tjetër fatmirësisht po kruhet pa telashe me rritje të çmimeve. Është projekt 1.5 milion euro. Pra qëllimi i atij takimi që përmende ka qenë që të shtohet intensiteti i punimeve. Ata janë zotuar që deri me 1 korrik do të përfundojnë këto dy projekte. Të gjitha të tjerat që i përmendë unë jam i hapur që të i diskutojmë por nuk vendos Zenun Elezi për gjithçka. Besoni që përkushtimi im dhe i ekzekutivit është maksimal. Problemi i punësimit është i madh sepse unë kam [pakënaqësi edhe në familjen time ngase të gjithë nuk mund të punësohen. Ju po e përmendi gjithnjë Zenun Elezi, Zenun Elezi por është mendimi i juaj, unë jam duke u përpjekur që të punoj ndershëm dhe me përkushtim sipas ligjit.

z. Zafer Gashi: Unë e përmenda atë që është pozitive kur thash që takimet e kryetarit me OJQ dhe donator janë për tu përshëndetur ndërsa pjesa tjetër që e përmenda komplet qëndron dhe do ta tregoj koha, mos qofsha në lëkuren e disave, po e them këtë ashtu siç e ka thënë në seancën e kaluar kur e formuam komisionin hetimor për procedurat e dhënies së lejes së ndërtimit të fabrikës së çimentos, kolegu ynë Kola.

Pika 9 e Rendit të Ditës: Rishqyrtim i vendimit për ndarjen e parcelës për ndërtimin e objektit të zjarrfikësve

Kryesuesi sqaroi kërkesën nga Ministria për rishikimin e këtij vendimi. Ai theksoi se vendimi ynë është në ueb faqe të komunës sepse i ka kaluar afatet e kthimit të përgjigjes por me gjithë këtë ata kanë kërkuar që ta rishqyrtojmë pasi që nga ministria thuhet se vendimi ynë është në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi porse nuk sqarohen cilat janë ato dispozita që kemi rënë ndesh. Ne nuk kemi rrugë tjetër përveç se me e respektuar ministrinë në fjalë dhe gjithë ministrinë tjera por edhe ata uroj që ta marrin këtë mesazh- duhet të i përmbahen afateve që janë të caktuara sipas rregulloreve në fuqi. Në lidhje me vendimin konkret, mendoj që nëse ne para disa vjetëve kemi pasur të drejt në vitin 2005 që ta zhvendosim stacionin e policisë nga këtu në një vend tjetër sigurisht që kemi të drejt edhe nga atje ta zhvendosim në një vend tjetër. Ata an thonë që ta pyesim shfrytëzuesin e hapësirës. JHo me u pyet pronari i hapësirës por shfrytëzuesi, ndërsa ne jemi pronari i asaj hapësire që duhet at pyesim shfrytëzuesin. Kryesuesi Gashi, shpjegon ne detaje për cilën parcele bëhet fjalë dhe sa është madhësia e parcelës që është 72 ari e disa qindra metra, sa i janë ndarë për objektin e zjarrfikësve dhe sa i janë mbetur stacionit të Policisë. Kjo hapësirë është edhe me harta zonale të miratuara që parasheh ndërtimin e objekteve institucionale por gjithsesi ne do ta rishikojmë.

Ai e vendosi në votim duke pyetur se a pajtohen me gjitha ato që i tha kryesuesi duke thënë se për aq sa ka kompetencë kuvendi i Komunës do të harmonizohet sipas kërkesës.

Me 23 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim U MIRATUA

Pika 10 e Rendit të Ditës: Pyetje dhe Përgjigje

z. Esat Raci: Unë kam dy pyetje. Pyetja e parë për kryetarin e Komunës- çfarë u bë me stacionin e autobusëve. Pyetja e dytë për ju kryesues- Fabrika e çimentos. Sipas informative të fundit, vendimet që i kemi marr në seancën e jashtëzakonshme në vitin 2020 MAPL e ka dërguar për interpretim në gjykatë apo e ka paditur Komunën. Nëse Gjykata merr vendim pozitiv në favor të Kuvendit, çfarë do të behën me ato leje e pëlqime duke përfshirë edhe lejen e ndërtimit?

z. Zenun Elezaj, kryetar i Komunës: Për stacionin e autobusëve realisht është në përfundim e sipër por ende nuk është bërë pranimi teknik i fazës së parë, kjo ka të bëjë me rregullimin e peronave dhe infrastrukturë tjetër. Ne i kemi dhënë afat kompanisë dy javë dhe veçse është në skadim të afatit. Pas pranimi teknik të fazës së parë ne do të marrim vendimet tona edhe si ekzekutiv por edhe si kuvend në drejtim të themelimit të kompanisë publike. Është më pastaj faza e dytë që do të behën mbulesat e peroneve dhe të kompletohet. Pas pranimi teknik të fazës së parë unë po mendoj që të takoj pronarët e autobusëve dhe të bëjmë një zgjidhje për parkimin e tyre dhe funksionimin.

z. Fadil Gashi, kryesues: Ministria na ka paditur dhe unë e diji që edhe zyra ligjore edhe ekzekutivi ju ka përgjigjur padisë. Jemi duke e pritur epilogun. Kush fiton nuk e diji as unë. Nëse vendimi i gjykatës na e rrezon vendimin duhet ta respektojmë e nëse vjen pozitiv në favor tonin atëherë të gjitha lejet e dhëna bijën poshtë.

z. Tunë Dedaj: Unë kërkoj nga ju kryesues që të gjithë anëtarët e kuvendit të kemi të instaluar mikrofonin në tavolinë aty ku jemi të ulur.

z. Fadil Gashi, kryesues: pajtohem plotësisht.

Znj. Valmira Krasniqi: Dua ta pyes kryetarin se pse nuk është bërë publike në faqen e Facebook të komunës seanca e jashtëzakonshme? A vetëm sepse është thirr nga opozita apo pse?

z. Zenun Elezaj, kryetar i Komunës: Nuk besoj që është ajo arsyeja. Është dashtë me u publiku. Nuk e diji , nuk e përcjelli shumë FB. Do të interesohem.

Znj. Valmira Krasniqi: Kam edhe dy pyetje nëse më lejohet. Një për kryetarin dhe një për drejtoreshën e DKRS. A ka përfituar grande qeveritare Komuna e Klinës nga Ministria e pushtetit lokal në vitin 2022?

z. Zenun Elezaj, kryetar i Komunës: Sipas procedurave, Komuna e Klinës nuk ka përfituar. Ne kemi bërë ankesa. Nuk e kemi plotësuar një nga katër kriteret që duhej plotësuar. Nuk kemi anuluar vendimet e Kuvendit prandaj nuk e kemi plotësuar këtë kriter. E drejta është në anën tonë sepse ne kemi pritur afatet ligjore dhe jemi konform ligjit. Jemi paralizuar pa të drejt prandaj kemi bërë ankesë.

z. Fadil Gashi, kryesues: Ashtu siç e tha edhe kryetari. Jemi penalizuar pa të drejt. Është neni 81 i ligjit për vetëqeverisje lokale i cili thotë: Autoriteti mbikëqyrës obligohet që të jap mendimin e tij për ligjshmërinë e çdo akti të regjistruar, brenda 15 ditëve nga pranimi i tij. Dhe ne nuk ka akt që e kemi shpallur ose proceduar pa skaduar ky afat. Nuk ka kërkesë nga ministria që ne si shërbim i kuvendit nuk i përgjigjemi. Të gjitha rregulloret e udhëzimet e tjera derivojnë nga ligji që e citova. Asnjë organ tjetër nuk mund ti anuloj vendimet tona përveç një vendim i gjykatës. Prandaj po na penalizojnë pa të drejt. Ne jemi partnerë me Ministrinë, por kjo nuk do të thotë se duhet të pranojmë çdo gjë.

z. Enver Gashi: Është një shqetësim i drejtorëve të shkollave bazuar në një shkresë së DKA ku thuhet: sipas kërkesës së drejtorit të DKA-së bëhet ndalimi i kremtimit të ditës së shkollave. Pyetja e ime është- ku është arsyeja? A keni të drejt të bëni anulimin e kremtimit të ditëve të shkollave pa një vendim dhe pa asnjë arsytim.

z. Tunë Dedaj: E përkrahu edhe unë këtë shqetësim të shprehur nga Enver Gashi. Edhe mua më kanë pyetur shumë se pse duhet anuluar kremtimi i ditëve të shkollave.

z. Zenun Elezaj, kryetar I Komunës: Mendoj që duhet të vazhdohet të mbahet kremtimi I ditëve të shkollave. Do ta diskutoj me drejtorin e DKA këtë shkresë. Unë dje kam marr pjesë në një kremtim të ditës së shkollës. Nëse nuk ka ndonjë shkresë nga Ministria, do ta rishikojmë këtë njoftim.

z. Fadil Gashi, kryesues: Në këtë njoftim shkruan: Sipas kërkesës së drejtorit të DKA ju njoftoj se DKA ka ndaluar kremtimin e ditëve të shkollave. Njoftimi është përcjellë nga Hajdin Morina, data është 5 maj 2022 ora 9:55.

z. Kushtrim Haliti: Pyetja ime për drejtorin e bujqësisë. Grandet që janë dhënë në vitin 2022, serat, mjelëset dhe spërkatëset. Ka qenë komisioni I përberë nga asnjë zyrtar I drejtorisë së Bujqësisë. Pse s' ka qenë asnjëri anëtar nga drejtoria e bujqësisë. Shkelja që ka bërë ky komision është se në vitin 2019 një votuesi të AAK-së I kanë dhënë 50 ari lajthi si dhe në vitin 2022 ja kanë dhënë seren. Dy herë grand. Ndërsa ka shumë persona që kanë aplikuar dhe nuk kanë përfituar asnjëherë.

z. Zenun Elezaj, kryetar: Me sera kanë përfituar të gjithë qytetarët e Komunës së Klinës, kam insistuar që të përfitojnë ata që kanë nevojë. Nëse ka një shkelje të tillë do ta delegojmë . E diji që kriter ka qenë që mos të jetë përfitues dy herë të grandeve prandaj nëse është ashtu ke plotësisht të drejt. Jam I informuar me problemet që komisioni ka pas në teren. Një anëtar I cili ka pas problem ka dhënë dorëheqje. Është gabim I madh që të shkohet e të I kumtohet aplikuesit se s' ka përfituar grande.

Znj. Marigona Raci: Përhëndetje. Kompetencë e kujt është thirrja e mbledhjes së komitetet për shëndetësi, anëtar I atij komiteti jam edhe unë por që akoma nuk e ka thirr askush mbledhjen.

z. Fadil Gashi, kryesues: Kompetencë është e kryesuesit të atij Komiteti. Ju bëj thirrje që të mbahen takimet e komiteve. Mëditjet do të ju paguhen sepse kjo çështje është rregulluar tash më. Po e shfrytëzoj rastin që të përsëris kërkesën që procedura e pajisjes së anëtarëve të kuvendit me lllaptop të shpejtohet.

Znj. Valmira Krasniqi: Doja edhe pyetjen e dytë për drejtoreshën e DKRS. Pse është anuluar thirrja për aplikim për subvencionimin e OJQ-ve. Nuk është cekur fare arsyeja e anulimit. Do të doja të dija gjithashtu se sa është shuma e planifikuar për subvencionim.

Znj. Fatjona Gashi, drejtoreshë e DKRS: Të nderuar anëtarë të Kuvendit dhe pjesëmarrës në mbledhje. E nderuara znj. Krasniqi, njoftimi është bërë në bazë të vendimit të cekur me nr. Protokolli. DKRS shpall thirrje publike duke u bazuar në rregulloren e Ministrisë së Financave, rregulloren me nr. 04/2017. Sipas kësaj rregullore dhe nenit 8 ne e kemi formuar komisionin vlerësues I cili ka rekomanduar që kjo thirrje të anulohet sepse afërsisht 90% e OJQ-ve nuk e kanë sjellë dokumentacionin e kompletuar. Me qellim që këto subvencione të ndahen në mënyrën sa më të mirë ne e kemi anuluar këtë thirrje por që do ta shpallim serish në një kohë të caktuar dhe të arsyeshme paraparë gjithmonë me rregulloren që e përmenda. Edhe anulimi është bërë sipas rregullores e cila na lejon neve si institucion që të marrim një vendim të tillë për anulim.

z. Shemsedin Berisha: Kam një pyetje për drejtorin e Urbanizimit. Rruga Dollc- Gjakovë e nisur në mandatin e kaluar është ndërprerë dhe aty ku ka mbetur është dëmtuar shumë. Unë ju kërkoj që të I bëni një shkresë ministrisë që të paktën të vijë të I rregulloj operatori, prishjet që I kanë bërë vet ata. Po ashtu ju kërkoj që të bëni kërkesë në Ministri që të ndërtohet një rreth rrotullim në lidhësen e rrugëve Prishtinë- Gjakovë –Pejë.

z. Enver Berisha, drejtor I Urbanizmit: Përshëndetje për të gjithë. Shqetësimi I Shemsedinit është shumë me vend sepse vërtet kyçja në rrugën Klinë –Gjakovë e fshatrave: Volljak, Dush, Sferkë, Qupevë është mjaftë e dëmtuar. Aty ka ndërhyrë një operator I cili ka filluar punimet dhe I ka ndërpreë. Nuk kemi pasur mundësi që të ndërhyjmë sepse nuk është kompetencë e jona të ndërhyjmë në rrugët magjistrale. Kam komunikuar me operatorin I cili ka premtuar që do ta sanoj por që akoma nuk e ka kryer. Sa I përket rreth rrotullimit në lidhësen e rrugëve Prishtinë-Gjakovë-Klinë- Pejë, mendoj që kryetari disa herë ka bërë tentativa që të rregullohet por ajo rrugë është në menaxhim të ministrisë së infrastrukturës. Ne kemi bërë përpjekje që të ndërhyjmë por nuk na është dhënë leja. Shqetësimi I qytetarëve dhe I asamblistëve është shumë më vend. Sa I përket ujit në atë pjesë, ka përfunduar procedura e prokurimit dhe jemi në fazën e lidhjes së kontratës. Për fund dua që të kërkoj nga komisioni për emërimin dhe riemërimin e rrugëve që të nisi punën sa më shpejt që të jetë e mundshme.

z. Kushtrim Haliti: Unë jam anëtar I atij komisioni por askush nuk na ka ftuar deri tani.

z. Zafer Gashi: E lus kryetarin që të më përgjigjet se a e ke marr kërkesën time të datës 04. 03. 2022?
Lënda: Informatë zyrtare , sqaruese për kriteret e caktuara të vendosjes së panos reklamuese të bizneseve në Klinë. A e ka marr këtë kërkesë apo nëse jo a mund ta ri përsëris?

z. Zenun Elezaj, kryetar I Komunës: Nuk besoj por edhe nëse ka ardhur ajo I është dërguar komisionit I cili është përgjegjës për përgjigje dhe problem të kësaj natyre. Komisioni është I emëruar që të vlerësoj çdo situatë. Përgjegjësia është e tij. Unë nuk kyçem në këto punë.

Me përfundimin e të gjithë të interesuarve për pyetje në këtë pikë të rendit të ditës, kryesuesi z. Fadil Gashi I shpalli të mbyllura punimet e kësaj seance duke falënderuar të gjithë për kontributin dhe pjesëmarrje.

Procesmbajtës:

Skënder Behramaj



Kryesuesi:

Fadil Gashi

